



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.201_

Lënda: Kthim përgjigje

Rruga: _____, Tiranë

Në përgjigje suajës, me datë 11.07.2019, në lidhje me kërkesën tuaj për informacion ju bëjmë me dije se:

1. Bashkia Shkodër ka zhvilluar thirrje të hapur në faqen e saj web, www.bashkiashkoder.gov.al, me datën 4 Prill 2019, thirrje së cilës i janë përgjigjur 82 subjekte, nga të cilët 70 subjekte kanë rezultuar me dokumentacion të plotë ligjor dhe janë lajmëruar që të plotësojnë kushtet e përcaktuara nga VKM 171, 27/03/2019. Ndërkohë një pjesë e subjekteve kanë plotësuar kushtet dhe po procedohet me lidhjen e kontratave.
2. Përlllogaritja e tarifës së zënies së hapësirës publike në plazh bëhet sipas paketës fiskale në fuqi të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, të cilën mund ta gjeni të publikuar në faqen web të Bashkisë Shkodër,
http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/paketa_fiskale_bashkia_shkoder_e_perditsuar_dt_01_01_2019_2269.pdf, fq. 47.

Tabelë Niveli i tarifës për zëniene hapësirave publike

Destinacioni i hapësirës	Njësia	Tarifa
1.a Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli) NJA Shkodër	lekë/m ² /muaj	140
1.b Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli) NJA të tjera (përveç Shkodër, Velipojë - Rrjoll Plazh)		70
2.a Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Velipojë - Zona A/V (nga qendra me koordinata 41°51'41.36"N, 19°25'29.33"E në drejtim të Vilunit me koordinata 41°51'36.34"N, 19°25'59.29"E)	lekë/m ² /muaj	140
Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Velipojë - Zona A/B (nga qendra me koordinata 41°51'41.36"N, 19°25'29.33"E në drejtim të Derdhjes së Bunës me koordinata 41°51'32.70"N, 19°24'42.73"E)	lekë/m ² /muaj	140
2.b Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Velipojë - Zona B/V (nga koordinatat 41°51'36.34"N, 19°25'59.29"E në drejtim të Vilunit me koordinata 41°51'29.70"N, 19°26'46.75"E)	lekë/m ² /muaj	100
Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Velipojë - Zona B/B (nga koordinatat 41°51'32.70"N, 19°24'42.73"E në drejtim të Derdhjes së Bunës me koordinata 41°51'12.06"N, 19°24'00.00"E)	lekë/m ² /muaj	100
2.b Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Rrjoll - Zona A/Rr (nga koordinatat 41°51'20.61"N, 19°27'44.45"E në drejtim të Rërës së Hedhur me koordinata 41°51'10.98"N, 19°28'32.81"E)	lekë/m ² /muaj	100
3 Zënie e hapësirës publike ditore për qëllime biznesi: ekspozim – promovimi produkteve, shërbimeve, aktivitete tregtare, etj.	lekë/m ² /ditë	200

- Janë 2 fasha çmimesh të identifikuar dhe të shprehura me referenca gjeografike të cilat janë në normën 140/lekë/m²/muaj dhe 100/lekë/m²/muaj. Norma e tarifimit në zonën qendrore është më e lartë se në zonën periferike.
- Përpara lidhjes së kontratës, inspektorët e Bashkisë Shkodër inspektojnë çdo subjekt të kualifikuar për lidhje kontrate për plotësimin e kushteve të përcaktuara në VKM 171, kryesisht për ato kushte që lidhen me sigurinë e pushuesve.
Në lidhje me pyetjen e fundit, sqaroj se Bashkia Shkodër nuk ka kompetenca inspektimi në këtë fushë, këtë funksion e kanë Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit si edhe Drejtoria e Shëndetit Publik.

Me respekt,

KRYETAR
Voltana Ademi

Me vendim delegimi 109, dt 29/06/2019
ZV/KRYETAR

Emilja Koliqi